



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS** **KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA**

### **Procesverbal i mbajtur më 31 tetor 2024, në mbledhjen e XXIX-të (njëzetënëntë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.**

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:15.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokrri; Bashkim Sylja; Mrika Thaçi dhe Qëndrim Softolli) bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje e pranishëm ishin edhe; *Adelinë Stublla drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS; Fatlum Osmani drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ; Leutrim Krasniqi drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM.*

### **Rendi i ditës**

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit**, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, konstatoi kuorumin, ndër të tjera theksoi, thirrja dhe materiali i kësaj mbledhje besoj se të gjithëve ju është dërguar dhe e keni pranuar me kohë, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i Autorizuar për ushtrimin e punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe fushveprimtaria e DPKGJ, theksoi, më lejoni që të propozoj edhe tri pika të reja për rend të ditës si pika shtesë përmes Komitetit për Politikë dhe Financa. Arsyeja e propozimit të këtyre pikave shtesë është për shkak të disa kërkesave që kanë ardhur nga disa institucione dhe një Ndërmarrje Publike Komunale, e që ka qenë e pamundshme të përgatitet materiali për seancë të rregullt.

Bëhet fjalë për pikat:

1- Propozim për dhënie të pronës në shfrytëzim për NPL “Stacioni i Autobusëve” në Podujevë, për çka të gjithë jemi të informuar se procesi i ndërtimit të Stacionit të Autobusëve ka përfunduar dhe pritet që brenda që brenda pak ditëve të vihet në funksion dhe prona ku është ndërtuar Stacioni i Autobusëve figuron në emër të Komunës së Podujevës, mirëpo nevojitet t’i jepet në shfrytëzim NPL “Stacioni i Autobusëve”.

2- Ndarja e mjeteve financiare për NPL Stacioni i Autobusëve”, pra sërish lidhet me NPL “Stacioni i Autobusëve” e që si Ndërmarrje nuk ka qenë deri tani në gjendje të mirë financiare dhe ka pas shumë probleme duke përfshirë edhe pagesën e pagave për punonjësit e tyre për shkak se funksionimi i tij nuk ka mund të bëhet në mënyrën më të mirë financiare, kështu që tani vetëm se po vendoset në objektin e ri dhe kësaj Ndërmarrje i nevojitet një ndihmë apo një lloj infuzioni nëse mund ta quaj kështu me qëllim të rimëkëmbjes së saj kështu që propozojmë që kësaj Ndërmarrje t’i ndahen 30,000.00€ si subvencion me qëllim të ndihmës për funksionimin më të mirë të kësaj Ndërmarrje dhe rimëkëmbjen e saj.

3-Propozim për dhënien në shfrytëzim pronën komunale KEDS-it, pra kemi një kërkesë të KEDS për dy parcela të vogla për ndërtimin e dy trafove, njëra në fshatin Sakavicë dhe tjetra në fshatin Llapashticë e Epërme, për çka kemi pas konsultime ligjore dhe kemi ardh deri te një çështje e cila edhe është në propozim në mënyrë kësaj radhe do të thotë është e domosdoshme t'iu jepen parcelat në shfrytëzim për ndërtimin e trsfove sepse është në interes publik mirëpo e kemi parë të arsyeshme që kjo të jetë me pagesë sepse realisht neve KEDS po na tarifon edhe si institucione publike e që është krejt në rregull prej anës së tyre, por është në rregull edhe prej anës tonë që të ketë një pagesë për trafon të cilën e vendos në një lokacion që është pronë publike, dhe ne kemi propozim që qiraja të jetë 1 euro për m<sup>2</sup>, në muaj dhe pagesa të bëhet njëherë në vit, pra 1 euro në muaj për 1 m<sup>2</sup> për vendosjen e trafo në lokacionet e cekur në dy fshatrat përkatëse.

Faleminderit për vëmendjen, tani do t'ju shpërndahen propozimet dhe materialet e këtyre pikave e që mund t'i analizoni, dhe ju ftoj t'i mbështetni këto propozime në mënyrë që të kalojnë për diskutim dhe aprovim në seancën e Kuvendit.

**z.Bashkim Syla**, theksoi, edhe unë kam një pikë shtesë - propozim për përfshirje në rend të ditës që është hartimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2025 dhe njëkohësisht për përgatitjen e këtij Plani të organizohet një punëtori 2 ditore në mënyrë që gjithsecili nga anëtarët e Kuvendit të mund të jep kontributin e vet në hartimin e Planit të cekur.

Sa i përket tri pikave të propozuara si pika shtesë nga drejtori parafolës, konkretisht propozimit për ndarjen e mjeteve financiare për NPL “Stacioni i Autobusëve” unë mendoj se shuma e propozuar është e vogël dhe nuk i plotëson kushtet për funksionalizmin e Ndërmarrjes, si dhe në kuadër të kësaj ka qenë edhe një kërkesë nga Bordi i Stacionit të Autobusëve drejtuar Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave respektivisht Komunës që në kuadër të kësaj të hyjë edhe një propozim i cili lejon pagesën e anëtarëve të komisionit të aksionarëve ashti siç ka funksionuar me 2 ndërmarrjet publike tjera, mirëpo ajo kërkesë nuk është sjellë këtu e që mbetet të silllet ose përmes Kryesuesit të Kuvendit ose të futet si pikë e rendit të ditës në seancën e Kuvendit që tash më veç është caktuar më datën 04.11.2024.

Përndryshe ne Grupi i PDK-së si propozime i përkrahim me përjashtim për shumën e ndarë e cila mendojmë se është e vogël dhe nuk i plotëson kushtet për funksionalizmin e Ndërmarrjes.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, rreth propozimeve për shtimin e pikave shtesë të rendit të ditës, në veçanti propozimit për dhënien e pronës së paluajtshme komunale Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A, që në fakt Stacioni është ndërtuar në atë sipërfaqe dhe gjendet në atë parcelë, ndërsa sa i përket propozimit të dytë që kësaj Ndërmarrje të ndahen mjete financiare në shumë 30,000.00€ është çështje që e kemi praktikuar edhe me NPL “Eko-Llapi” e që ndoshta për fillim mund të jenë 30,000.00€, mirëpo duhet ta dimë që Ndërmarrjet Publike me rastin e themelimit duhet ditur që ato duhet të qëndrojnë vetë sa i përket aspektit financiar përmes shërbimeve dhe inkasimit të të hyrave nga ato shërbime e jo me ato të hyra të mbeten barrë e buxhetit komunal por përkundrazi të jenë si lehtësim.

Sa i përket propozimit tjetër që e bëri kolegu z.Bashkim Syla për hartimin e Planit të punës së Kuvendit, i nderuar Kryesues Planet e punës po i hartojmë por nuk po i'u përmbahemi mirëpo është obligim ligjor ta kemi Planin e punës së Kuvendit për vitin pasues dhe e mbështesë propozimin e kolegut që në hartimin e Planit të mos veprojmë sikurse në praktikat e kaluara sepse vetëm ne e kemi në funksion një gjë të tillë ngase për hartimin e Planit të punës duhet të krijohet hapësirë për të gjithë anëtarët/et e Kuvendit të Komunës në mënyrë që të gjithë ta kenë të drejtën që paraprakisht të shfaqin mendimet e tyre gjegjësisht se çka e shohin si punë për të trajtuar Kuvendi si analizë.

**z.Haki Rudari**, theksoi, edhe unë dua të ndalem paksa tek propozimet që u paraqiten tani, janë ardhur në këtë formë dhe sigurisht do të vijnë sërish, pastaj janë ardhur edhe më herët. Do të ishte mirë që kjo formë e tillë nëse ka mundësi të vijnë me rregull dhe me kohë materialet për arsye se aty për aty pastaj po kemi vështirësi në përgatitjen e materialeve edhe pse ne natyrisht se i kuptojmë që nëse ka ndonjë emergjencë krejt në rregull është, pastaj e dim që edhe në kuptimin ligjor është e drejtë të sjellën në këtë formë, por mundësisht e them se nëse ekziston mundësia sa më pak të sjellën pika të renit të ditës dhe materiale në këtë formë si propozime sepse pastaj po kemi vështirësi të përgatitemi duke qenë në dijeni për sasinë, parcelat, numrat e kompletë krejt, siç është rastin i këtyre propozimeve tani.

Edhe njëherë po e them se kur ka ndonjë emergjencë është e drejtë, mirëpo mundësisht të na sjellën materialet me kohë për rendin e ditës.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, më shtyu të marrë fjalën sërish parafolësi z.Haki Rudari, vërtetë ne si KPF disa herë ne këtu kemi marrë disa qëndrime tonat që në rend të parë nuk i'u kemi përmbajtur ne dhe me plotë arsyeshmëri e përkrahë që pikat të cilat mund të trajtohen në formën e rregullt siç i takon një vendimmarrje të Kuvendit të Komunës të mos ndodh të na sjellën në formën siç po na sjellën sepse fundja kur të diskutojmë për këto pika që u paraqiten nga drejtori i DBF-së, që të dyja nuk janë diçka e re, diçka e befasishme, mirëpo jemi në dijeni se kur është përruar objekti i Stacionit të Autobusëve dhe tani jemi në dijeni se këto është dashtë të kalojnë me kohë në një procedurë të rregullt dhe normale, edhe pse edhe këtë formë e parasheh ligji dhe nuk po e them se nuk e parasheh, mirëpo po ta kishim me kohë sigurisht se nuk do ta bëja edhe gabimin e mëparshëm kur nuk arrita të shohë aq shpejt sipërfaqen se sa m 2 ju janë ndarë Stacionit të Autobusëve, ngase nuk mundesh aty për aty të vendosësh për një diçka të tillë.

Unë gjithëherë e përkrahë dikë kur është parimor siç ishte ky rast tani me kolegun parafolës zotëri Rudari sepse fundja këtu jemi për vendime të Komunës dhe interesa të qytetarëve pavarësisht nganjëherë germave dhe numrave që përdorim, e mira e qytetarëve është e mirë qytetare pavarësisht kësaj.

Për fund dua të them se kjo praktikë e sjelljes së pikave të rendit të ditës përmes KPF-së do të ishte mirë të ndalej e për çka këtu kemi pasë një qëndrim të përbashkët që as ti zotëri Rudari e as Kryesuesi i Kuvendit nuk i'u ka përmbajtur, që ka qenë se çdo dikaster i Ekzekutivit kur propozon pika të rendit të ditës nëse nuk është këtu prezent për të dhënë arsyeshmëri të mos e përkrahim atë pikë, por e kemi thyer atë qëndrim edhe tani po bëjmë të njëjtën qysh e kemi bërë.

Pra kisha dilemën për të votuar apo jo për një material që nuk kemi pas mundësi ta konsultojmë, prandaj e përkrahi kolegun z.Haki Rudari për ndaljen e kësaj praktike për aq sa është e mundur të ndalet.

Sa i përket propozimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale KEDS-it, nuk është hera e parë që KEDS i drejtohet me kërkesa Komunës së Podujevës për marrjen e pronave në shfrytëzim. Disa që janë këtu dhe që kanë qenë edhe në mandatet e kaluara e dinë që KEDS është Ndërmarrje private e cila vazhdimisht shfrytëzon prona private të qytetarëve dhe prona komunale pa kurrfarë kompensimi.

Ne në një prej mandateve të kaluara kemi provuar të kërkojmë nga KEDS pagesë për shfrytëzimin e pronës siç do të ishte normale për një ekonomi të tregut që të paguhet për pronën që e merr në shfrytëzim, por që disa herë ato vendime na janë kthyer për shkak se ajo kompani e ka monopolin dhe në një formë kushdo që dëshiron t'i përmirësohet gjendja e rrymës, përndryshe kanë thënë se nuk paguajmë, prandaj mua më pëlqeu ajo që KEDS i është vë taks, sa do qoftë ajo, por që duhet ta din ajo Kompani se është duke shfrytëzuar pronë të huaj dhe fiton në emër të asaj prone sepse nga shërbime e saja inkason të hyra, prandaj nëse tani ju i nderuar drejtor i DBF-së e keni konsultuar KEDS-in është gjë e mirë, nëse jo mund ta vazhdojnë me atë të vjetrën që të mos paguajnë taks

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, pati diskutime edhe pse ende nuk e kemi miratuar rendin e ditës, andaj të votojmë fillimisht për propozimet e paraqitura, pastaj për rendin e ditës në tërësi dhe kur të vie rendi për diskutime në pikat përkatëse atëherë mund të diskutojmë dhe të jepem sqarimet dhe përgjigjet e nevojshme, tani jemi në fazën të hyjnë apo jo si pika shtesë propozimet e paraqitura. Pra i hedh në votim një nga një sipas renditjes dhe materialit të paraqitur.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, mbështetet propozimi për përfshirje në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje, edhe pika shtesë:*

**-Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. në Podujevë**

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, mbështetet propozimi për përfshirje në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje, po ashtu edhe pika shtesë:*

**-Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A.**

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, mbështetet propozimi për përfshirje në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje, po ashtu edhe pika shtesë:*

**-Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS Sh.A.**

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, mbështetet propozimi për përfshirje në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje, po ashtu edhe pika shtesë:*

**-Hartimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2025 nga anëtarët/et e Kuvendit të Komunës përmes organizmit të një punëtorie të përbashkët dy ditore.**

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, tani e hedhim në votim rendin e ditës në tërësi sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe 4 pikat shtesë që u mbështeten paraprakisht për të hyrë në rend të ditës si pika shtesë.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri nga 9 anëtarët e Komitetit miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje si dhe propozimeve të paraqitura si më lartë për përfshirje në kuadër të rendit të ditës si pika shtesë në këtë mbledhje.*

Pikat e rendit të miratuar të ditës:

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtura më 11 shtator 2024 dhe 25 shtator 2024
2. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar - shtator 2024
3. Propozim vendimi për vënie në konsultim publik të:  
- Draft Planit Lokal për Veprim në Mjedis 2024 - 2029
4. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. në Podujevë
5. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A.
6. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS Sh.A.
7. Hartimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2025 nga anëtarët/et e Kuvendit të Komunës përmes organizmit të një punëtorie të përbashkët dy ditore.

## **1. Procesverbalet nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtura më 11 shtator 2024 dhe 25 shtator 2024**

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, miratohen pa vërejtje apo plotësim ndryshime Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtura në mbledhjet e 11 shtatorit 2024 dhe 25 shtatorit 2024*

## **2. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar - shtator 2024**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i Autorizuar për ushtrimin e punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe fushveprimtaria e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrës rreth raportit në fjalë, theksoi, në bazë të legjislacionit në fuqi e kemi detyrim të paraqesim raporte financiare për çdo tremujore lidhur me procesin e shpenzimit të buxhetit, kështu që materialin përkatës e keni marrë me kohë dhe ju ftoj ta mbështetni për diskutim në mbledhjen Kuvendit të Komunës.

**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e mbështesim që të jetë si rekomandim për seancën e Kuvendit e cila është caktuar të mbahet më 04.11.2024.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, rreth raportit financiar nëntëmujor janar - shtator 2024 unë pata disa pyetje, dhe ashti siç e ceku edhe drejtori parafolës se ky është një obligim ligjor i cili në kuptimin e llogaridhënies për menaxhimin e buxhetit të Komunës i cili është miratuar në muajin shtator të vitit të kaluar, dhe me dinamikën e realizmit të këtij buxheti paraqiten raporte periodike siç e kemi tani para vetës raportin periodik nëntëmujor për të cilin më vie mirë që tani është kujdesur ta sjellë këtë raport sepse në vitin e kaluar se ka sjellë fare, mirëpo rreth diskutimit më të gjerë për këtë raport dhe sa për insinuatë dhe se sa drejtë është shpenzuar buxheti i Komunës karshi vendimeve të Kuvendit, gjegjësisht planifikimeve buxhetore që janë miratuar këtu në Kuvend vitin e kaluar, ne do të japim kontributin tonë në seancën e Kuvendit, por sot vetëm një pyetje e kam për drejtorin e DBF-së, fjala është për një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve për Sindikatë e që në bazë të organizimit sindikal në Republikën e Kosovës sa unë jam në dijeni, mund të jem gabim, organizmi sindikal është vullnetarë dhe meqë është kështu si mund të ndodh që të ndahen dhe shpenzohen mjete buxhetore për pagesën e anëtarësisë së Sindikatës, në fakt në vitin 2023 nuk ka pasur pagesë për sindikatë kurse tani kemi shumë prej 18,963.41€, andaj kërkoj sqarim rreth kësaj.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i Autorizuar për ushtrimin e punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe fushveprimtaria e DPKGJ, theksoi, është e vërtetë që Sindikata është organizim vullnetar i punonjësve qoftë të arsimit, shëndetësisë, administratës dhe çdo sektori tjetër, tani kur përmes sistemit E-kosova e ka bërë një punonjës nga ndonjëra prej sektorëve të cekur dhe hyn në organizim vullnetar sindikal, pastaj në listën e pagave është rubrika ku në mënyrë automatike në bazë të marrëveshjes që kanë Sindikatat me Ministrinë e Financave, në listë të pagave ati punonjësi i ndalet anëtarësia e Sindikatës, ashtu siç janë rubrikat tjera të veçanta që janë paga bruto, tatimi, trusti e të tjera janë edhe shpenzimet sindikale që paguhen nga punonjësi nga paga e tij, pra ati punonjësi i zvogëlohet paga neto të cilën e merr mirëpo normalisht kjo është e paraqitur në raport financiar se sa mjete nga lista e pagave paguhen për Sindikata, pra nuk janë para publike por janë para të punonjësve të cilët janë në organizim vullnetarë dhe mjetet e anëtarësisë në Sindikata ndahen nëpërmes listës së pagave. Ndoshta keni mund ta shihni kur e nënshkruani listën e pagave figuron aty një rubrikë ku shkruhet shpenzimet e Sindikatës, pra kjo është arsyeja, përndryshe nuk janë para që ne i ekzekutojmë për Sindikatë.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar drejtor i DBF-së, nëse të kam kuptuar drejtë do të thotë ky kod buxhetor gjegjësisht kjo shumë rreth 19,000.00€ që figuron këtu, në një formë Komuna apo Ekzekutivi i Komunës është një ndërmjetësues në mes pagës së punëtorit që e ka marrë rolin e inkasimit të anëtarësisë dhe atë shumë e vë në fondin e Sindikatës, a është kështu apo jo, nëse po atëherë në rregull jemi.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i Autorizuar për ushtrimin e punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe fushveprimtaria e DPKGJ, theksoi, në një formë e sakt është qysh e potencoj parafolësi, pra është bërë përmes listës së pagave ndërsa ne si Komunë as nuk merremi me procesimin e tyre as asgjë por në mënyrë automatike lista e pagave e proceson këtë pagesë të anëtarësisimit në Sindikata.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim në mbledhjen e radhës raporti financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar-shtator 2024.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për diskutim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

### **3. Propozim vendimi për vënie në konsultim publik të:**

#### **- Draft Planit Lokal për Veprim në Mjedis 2024 - 2029**

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, Plani Lokal i Veprimet në Mjedis është një dokument strategjik i cili bashkon interesat e komuniteteve për një mjedis sa më të qëndrueshëm dhe në kuadër të këtij Drafti parashikohet dhe analizohet gjendja ekzistuese duke identifikuar problemet mjedisore, pastaj përcaktohen qëllimet afatgjate rreth atyre problemeve si dhe në fund parashihen si të ndërmerren masat konkrete.

Sigurisht se ju keni pranuar këtë material me kohë dhe e keni analizuar, por në kuadër të propozim vendimit kemi disa propozime për ndryshime dhe plotësime dhe atë te neni 1, tek kohëzgjatja e diskutimit publik të ndryshohet prej datës 20.11.2024 deri më 19.12.2024, kurse debati i përgjithshëm publik me qytetarë të mbahet më 03.12.2024, ku të gjitha sugjerimet, plotësim ndryshimet apo vërejtjet rreth këtij Draft Plani mund të dërgohen tek zyrtarët kompetent të caktuar apo në formën tjetër përmes Zyrës pritëse, andaj propozoj që ky Draft material të mbështetet si rekomandim për shqyrtim në mbledhjen e radhës së Kuvendit të Komunës.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, e dëgjova me vëmendje drejtorin parafolës në paraqitjen e fjalën hyrëse i cili qysh në fillim e potencoj se është një dokument strategjik dhe që unë mendoj se ky dokument rrjedh prej Strategjisë komunale dhe për derisa rrjedh nga ajo Strategji duhet të jetë një Plan operativ për rregullimin e kësaj fushe, dokument i cili besoj se është i nevojshëm dhe si do që të jetë një Plan i cili në fokus ka ndërtimin dhe rregullimin e një segmenti të caktuar sigurisht se do ta ketë mbështetjen tonë të Grupit të LDK-së edhe pse unë po e them por e potencoj drejtori parafolës se si Plan është i vonuar, mirëpo tani veç po hyjmë në muajin nëntor 2024, është procedura e konsultimit publik dhe efektet e tij ndoshta mund të shihen tek në vitin 2025.

Si do që të jetë ne do të mbështesim këtë Draft Plan dhe çdo Plan tjetër që është në të mirën e qytetarëve.

**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, ne Grupi i LVV-së e përkrahim që të jetë si rekomandim për Kuvendin e Komunës dhe meqë do të shqyrtohet në seancën e Kuvendit dhe po ashtu do të del edhe në konsultim publik do të kemi kohë të mjaftueshme të japim vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tona për këtë Draft.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim duke përfshirë edhe propozimet e bëra nga drejtori i Drejtorisë përkatëse në fjalën hyrëse.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri me 9 vota Për, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes përfshirë edhe plotësim ndryshimin e propozuar nga drejtori i Drejtorisë përkatëse, dhe atë: në nenin 1 të propozim vendimit, kohëzgjatja e diskutimit publik të ndryshohet dhe propozohet të jetë prej datës 20.11.2024 deri më 19.12.2024, kurse debati i përgjithshëm publik me qytetarë të mbahet më 03.12.2024.*

#### **4. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. në Podujevë**

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, për këto pikat shtesë që u futen në rend të ditës pothuajse në fillim të mbledhjes kur u propozuan dhe që u diskutuan, u jepen edhe sqarimet dhe përgjigjet e nevojshme, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri me 9 vota Për, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të prezantuar në fillim të kësaj mbledhje.*

#### **5. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A.**

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, po ashtu edhe për këtë pikë e cila hyri pikë shtesë, pothuajse u jepen sqarimet, mirëpo nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni nëse jo e hedh në votim që ti rekomandohet Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

Në fakt kolegu z.Bashkim Syla e vlerësoj si të ulët këtë shumë të mjeteve buxhetore, por si do që të jetë kemi mundësi të diskutojmë edhe në mbledhjen e Kuvendit ku edhe mund të ndryshohet.

**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, unë mendoj se kjo pikë e rendit të ditës të mbështetet si rekomandim për Kuvendin e Komunës që të shqyrtohet ashtu siç e ka sjellë si propozim drejtori i DBF-së, pastaj në Kuvend mund ta shqyrtojmë të diskutojmë dhe shohim se a mund apo jo të rritet shuma e mbështetjes për Ndërmarrjen në fjalë.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri me 9 vota Për, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të prezantuar në fillim të kësaj mbledhje.*

**6. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës  
Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS Sh.A.**

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, gjithashtu edhe për këtë pikë e cila hyri pikë shtesë, pothuajse u jepen sqarimet, mirëpo nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni nëse jo e hedh në votim që ti rekomandohet Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri me 9 vota Për, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të prezantuar në fillim të kësaj mbledhje.*

**7. Hartimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitit 2025 nga anëtarët/et e Kuvendit të  
Komunës përmes organizmit të një punëtorie të përbashkët dy ditore .**

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, edhe ky propozim u diskutua në fillim të mbledhjes, andaj e hedh në votim që të rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri me 9 vota Për, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas propozimit të prezantuar në fillim të kësaj mbledhje.*

*Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 10:50**

**Procesverbalin e mbajti;  
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0071471/24  
Podujevë,  
31 tetor 2024**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit  
Hilmi Hoxha**